

KËRKESË
Nr. 413/11, datë 7.4.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rezidenca e Ambasadorit të Republikës Italiane, në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

- Vlerësimi për pasuritë e llojit “ndërtesë” me funksion banimi është bërë bazuar në VKM-në nr.138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 459,279,249.30 (katërqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzet e nëntë pikë tridhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REZIDENCA E AMBASADORIT TË REPUBLIKËS ITALIANE, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË "

PRONARI				TË DHËNAT (Mbi pasurinë sipas ASHK)						VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË								VLERA TOTALE (LEKË)	SHËNIME
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr.Pasurisë	Lloji Pasurisë	Sipërfaqja Totale (m²)	Truall	Ndërtesë	Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jo banimi			
										Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip.Ndërt. konf. ASHK (m²)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas ASHK (l/m²)	Vlera (Lekë)	Sip.Nd. konf.nga ASHK (m²)	Vlera sipas Preventivit (lekë)		
1	JURGEN NIKOLAUS	SPIRO SPIRO	TRESKA TRESKA	8160	4/222	TRUALL	2283	2283	697.2	2,283.00	66,969.00	152,890,227.00	1721.7	170,314	293,229,613.80		446,119,840.80	KONTRATE SIPERMARJE / AKT MARVESHJE NDERMJET ZHVILLUESIT TE PRONES DHE PRONAREVE TE TRUALLIT E. OBJEKTI 2 KATE +BODRUM,KATI PERDHE SIPERFAQE BANIMI 697.2 M²,KATI NENTOKE SIPERFAQE BANIMI 364.8 M², KATI I PARE SIPERFAQE BANIMI 659.7 M²	
2	BEQIR SHEFQET RUKIJE FERID HATLIJE MERUSHE BEQIR	IBRAHIM IBRAHIM IBRAHIM IBRAHIM MAHMUT IBRAHIM	HUSHA HUSHA HUSHA HUSHA REÇI HUSHA	8160	4/710	TRUALL	196.5			196.50	66,969.00	13,159,408.50					13,159,408.50		
3	BASHKEPRONESI E DETYRUESHME PER OBJEKTIN MBI TRUALLIN ME NR.4/225 ZK.8160			8160	4/225	PALLAT	3045	3045	1093	106	0.00	0.00					0.00		
Shuma Paraprake																	459.279.249.30		